



**AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE
NJËSIA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE**

THIRRJE

Konferencë ndërkombëtare shkencore:

Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni

Tiranë më, 8-9 nëntor 2024

Inovacionet në fushën e inteligjencës artificiale (AI) vazhdojnë të formësojnë të ardhmen e njerëzimit në, pothuajse, çdo aspekt ekonomik, social, kulturor dhe arsimor. AI është tashmë shtytësi kryesor i teknologjive në zhvillime si, të dhënat voluminoze (*Big Data*), robotika dhe IoT, AI gjeneruese, të mësuarit e makinës (ML) dhe të mësuarit e thellë (DP), duke zgjeruar më tej mundësitë dhe popullaritetin e saj. E ardhmja e inteligjencës artificiale premtan shumë, me potencialin për të revolucionarizuar industritë dhe bizneset, për të rritur aftësitë njerëzore dhe për të zgjidhur sfidat komplekse. Ndërsa fusha e inteligjencës artificiale vazhdon të evoluojë me shpejtësi, konferencat luajnë një rol kryesor në bashkimin e ekspertëve, studiuesve, praktikuesve dhe drejtuesve të qeverisë dhe industrisë për të eksploruar tendencat, risitë dhe aplikimet më të fundit në teknologjinë AI. Këto konferenca shërbejnë si platforma për ndarjen e njohurive, bashkëpunimin dhe rrjetëzimin, duke nxitur përparimin në këtë fushë.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), në bashkëpunim me një grup universitetesh dhe institutesh akademike do të organizojë Konferencën ndërkombëtare “AI Horizon - a new era of creativity and innovation”, e cila do të mbahet në Tiranë, në datat 8-9 nëntor 2024.



Kjo konferencë synon të bashkojë akademikë, studiues shkencorë, profesionistë në një ngjarje të vetme për të diskutuar dhe konkluduar në lidhje me situatën aktuale të AI dhe zhvillimet e ekonomisë në kuadër të zbatimeve të reja teknologjike e inovative, për të eksploruar dhe debatuar tendencat, përparimet, teknologjitë dhe risitë më të fundit në AI.

Pjesëmarrja në këtë konferencë është ndërkombëtare falë partneriteteve shumë të rëndësishme dhe projekteve europiane në të cilat Akademia e Shkencave është partnere aktive.

Ndaj, qëllimi i konferencës “AI Horizon - a new era of creativity and innovation”, është të lidhë akademikët, kërkuesit dhe aktorët e tjerë, ekspertë në fushën e inteligjencës artificiale dhe shkencave kompjuterike brenda dhe jashtë vendit në një rrjetëzim sa më të gjerë. Prioriteti i saj është të ofrojë një platformë akademike për të gjithë ata brenda kësaj fushe, që të kenë mundësinë të ndajnë dhe diskutojnë gjetjet dhe zhvillimet brenda botës së AI, duke inkurajuar, promovuar e shkëmbyer informacionin shkencor.

Kjo konferencë mund të shihet si një mundësi e mirë në krijimin e komunitetit të AI e që mund të çojë në bashkëpunime të rëndësishme të aktorëve të ndryshëm që lidhen me të ardhmen e AI.

Ndërsa inteligjenca artificiale e drejtuar nga algoritmet vazhdon të përhapet, a do të jenë njerëzit më mirë sesa janë sot? Ekspertët thonë se rritja e inteligjencës artificiale do t'u bëjë më mirë shumicës së njerëzve, por shumë prej tyre kanë shqetësime se si përparimet në AI do të ndikojnë në vitet në vazhdim. Cilat janë parashikimet për të ardhmen? Një gjë dihet: Jeta njerëzore do të përshpejtohet, sjelljet do të ndryshojnë, qeveritë dhe industritë do të transformohen..., dhe kjo është ajo që mund të parashikohet me siguri.

Temat që mund të diskutohen janë ato të lidhura me AI:

Teknologjitë e AI:

- Përpunimi i gjuhës natyrore (NLP)
- Vizioni kompjuterik
- Të mësuarit e makinës (ML)
- Të mësuarit e thellë, rrjetet neurale
- Vizioni kompjuterik
- Robotikë
- AI gjeneruese
- Rrjetat e shpërndara të dijeve
- Të tjera ...

Aplikacionet e AI:

- AI në inteligjencën e biznesit
- AI në kujdesin shëndetësor
- AI në arsim dhe shkencë
- AI në financë
- AI në prodhimtari
- AI në shitje me pakicë
- AI në transport
- AI në energji
- AI në qeverisje
- Të tjera ...

Për detaje mbi tematikat mund të konsultohen:

- <https://cloud.google.com/discover/ai-applications>
- <https://dl.acm.org/ccs>

Zhvillimi i konferencës

Punimet do të pranohen në anglisht sipas formatit që do të qarkullohet, pas procesit të recensimit (*peer-review*), si dhe do të publikohen në linjë (*proceedings book*). Artikujt e përzgjedhur dhe të plotësuar mund të botohen në revistën e Akademisë AJNTS (Albanian Journal of Natural and Technical Sciences).

Seanca hapëse e konferencës do të zhvillohet më datën 8 nëntor 2024, Tiranë, ora: 16:00 deri në orën 20:00.

Gjatë seancës plenare do të përshëndesin drejtues të institucioneve të rëndësishme publike të vendit, akademike dhe drejtues të institucioneve akademike, përfaqësues të partneriteteve nga Bashkimi Europian, si dhe sponsorët kryesorë të konferencës.

Sesionet paralele, në të cilat do të prezantohen artikujt shkencorë dhe ku do të diskutohen temat kryesore të sesioneve paralele, do të mbahen më 9 nëntor 2024, Tiranë, nga ora 09:00-13:30.

Organizatorë të konferencës

Konferenca organizohet nga *Njësia e inteligjencës artificiale dhe Komisioni i matematikës dhe informatikës të ASHSH*, në bashkëpunim me:

- Universiteti i Tiranës (UT)
- Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)
- Universiteti *Epoka*
- Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
- Instituti *AlbShkenca* (IASH)
- Universiteti i Prishtinës *Hasan Prishtina* (UP)
- Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prishtinë
- Universiteti i Tetovës (UT)

Data të rëndësishme

Dërgimi i abstraktit (fakultativ, rekomandohet) deri më **25.09.2024**

Dërgimi i artikullit të plotë deri më **05.10.2024**

Konfirmimi i pranimit deri më **26.10.2024**

Komiteti organizator

- Kozeta Sevrani
- Arian Durrësi
- Neki Frashëri, email: nfrasheri@akad.gov.al
- Betim Çiço
- Elinda Kajo
- Alda Kika

Komiteti shkencor

- Skënder Gjinushi, ASHSH
- Arian Durrësi, ASHSH, Universiteti *Indiana*, SHBA
- Neki Frashëri, ASHSH
- Kozeta Sevrani, UT, ASHSH
- Alda Kika, UT
- Ana Ktona, UT
- Betim Çiço, Universiteti *Epoka*
- Bekir Karlik, Universiteti *Epoka*
- Dhimitri Tole, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
- Dorian Minarolli, UPT
- Edmond Hajrizi, UBT, Kosovë
- Elinda Kajo, UPT
- Fatmir Hoxha, ASHSH
- Fatos Ylli, UT, IASH
- Greta Angjeli, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
- Indrit Enesi, UPT
- Isak Shabani, UP, Kosovë
- Nevila Baci, FE, UT
- Endrit Xhina, UT
- Kreshnik Vukatana, UT
- Abdel-Rahman H. Tawil, Universiteti i Birmingham-it Angli
- Amarda Shehu, Universiteti George Mason, SHBA
- Anita Mirjamdotter, Universiteti i Linnaeus, Suedi
- Eugenio Brentari, Universiteti i Brescia, Italy
- Gentian Zyberi, Universiteti i Oslos, Norvegji. IASH
- Michael Langenbahn, Hochschule Koblenz, RheinAhrCampus Remagen, Germany
- Sanju Mishra Tiwari (SMIEEE), BVICAM, New Delhi, India; Universiteti Autonom i Tamaulipas, Meksikë & TIB Hannover
- Sule Yildirim Yayilgan, Universiteti Norvegjez i Shkencës dhe Teknologjisë
- Agon Memeti, Universiteti i Tetovës
- Edlira Kalemi, Universiteti i Birmigham, Angli
- Valentina Ndou, Universiteti i Salentos, Itali.
- Eshref Januzaj, Universiteti Teknik i Munihut, Gjermani, IASH
- Dashnor Hoxha, Universite d'Orleans, Francë
- Nandana Mihindukulasooriya, IBM Research AI, SMIEEE
- Romina Muka, UT, Akademia e të Rinjve e ASHSH

Komiteti teknik / Sekretaria

- Eljora Ndrelalaj, ASHSH; e-mail: eljora.ndrelalaj@akad.gov.al
- Nelda Kote, UPT
- Igli Draci, Universiteti *Epoka*
- Sabrina Begaj, Universiteti *Epoka*